



RAPORT MONITORIMI

1 Vit Pandemi

Nëntor 2020 -Janar 2021



AUTOR
STIVEN SHALA

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World

www.qeverisja.qq.com.al

ÇFARË VËRTETOI PANDEMIA COVID-19 PER SHQIPËRINË DHE SISTEMIN TONË SHËNDETËSOR?

Ashtu si në të gjithë botën, edhe vendi ynë u gjet i papërgatitur përballë një pandemie globale. Sistemet shëndetësore anembanë përfunduan në kolaps e kjo tregoi se qeveritë nuk i kishin kushtuar rëndësinë e duhur. Pandemia covid e nxori zbuluar sistemin shëndetësor shqiptar dhe dështimin e çdo hallke të shërbimit shëndetësor. Këtë dështim e kanë vuajtur dhe po e vuajnë me mijëra familje, pjesëtarët e të cilave u infektuan me covid dhe humbën jetën.



Në Shqipëri përgatitja për të përballuar pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, nisi me një Urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me datë 24 Janar 2020 "Për forcimin e përgatitjes për t'u mbrojtur ndaj depërtimit të koronavirusit të ri dhe parandalimit të përhapjes së tij

në Shqipëri". Në datën 24 mars 2020 qeveria shqiptare shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, kur ishin regjistruar vetëm 5 viktima nga 123 persona të prekur nga COVID-19. Sot, kemi rreth 85 mijë të prekur dhe rreth 1500 raste vdekjeje, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjatë pothuajse një vit pandemi, qeveria shqiptare mori shumë vendime që ndikuan jetën e çdo shqiptari, qoftë në ekonomi, në liri apo në shëndetësi.

Siç u theksua më herët, Shqipëria u gjen totalisht e papërgatitur, me një sistem shëndetësor të dobët e me mungesa personeli e infrastrukture. Sistemi ynë shëndetësor, edhe në kushte normale, mbetet një sistem me shumë probleme, një sistem që nuk arrin të funksionojnë si duhet e

të ofrojë atë çfarë duhet. Në Shqipëri, sistemi shëndetësor nuk i shërben qytetarit, por i shërben politikës e biznesit. Duket sikur shëndetësia është miniera e arit për politikanët dhe biznesmenët e se politika i është vënë në shërbim të plotë biznesit duke i lejuar të shfrytëzojnë në çdo aspekt sistemin e brishtë shëndetësor që kemi. Shembulli më konkret janë konçensionet, tenderat sekretë apo edhe mungesa e rregullimit të tregut. Me keq-menaxhimin që bëhet, është e pamundur të investohet në infrastrukturë apo në mjete që zhvillojnë sistemin dhe ia bëjnë punën më të lehtë personelit shëndetësor. E me largimin e mjekëve apo të infermierëve situata po vështirësohet gjithnjë e më tepër.

Largimi i mjekëve nga Shqipëria

Emigrimi i mjekëve dhe infermierëve është një fenomen që njihet që pas viteve 1990 ku ishin të shumtë ato që u larguan nga vendi e megjithatë ky largim kuptohet pse ndodhi dhe justifikohet. Sot ama, është totalisht e pajustificueshme që në vitet e fundit, Shqipëria vazhdon të humbasë gjithnjë e më tepër personel shëndetësor, gjithnjë e më tepër tru.

Sipas një kronike televizive të Tv Klan, nga në të dhënat e marra nga Urdhri i Mjekëve, rezulton se përgjatë 3 viteve të fundit, Urdhri i Mjekut në Shqipëri ka lëshuar 403 certifikata profesionale të sjelljes së mirë. 73 certifikata janë kërkuar nga mantelbardhët shqiptarë vetëm gjatë periudhës janar – shtator 2020, fakt ky shumë shqetësues që tregon se as pandemia nuk arriti t'i ndalë mjekët të largohen. Çertifikata e sjelljes së mirë lëshohet nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë dhe me anë të saj vërtetohet se mjeku është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se gjatë ushtrimit të profesionit nuk ka asnjë masë disiplinore kundrejt tij/saj.

Nga viti 2013 e më pas shihet se gjithmonë e më shumë mjekë po largohen.

Në 2013 janë pajisur me këtë certifikatë 76 mjekë të përgjithshëm.

Në 2014 janë pajisur me këtë certifikatë 128 mjekë të përgjithshëm.

Në 2015 janë pajisur me këtë certifikatë 124 mjekë të përgjithshëm dhe 19 mjekë specialistë.

Në 2016 janë pajisur me këtë certifikatë 165 mjekë të përgjithshëm dhe 43 mjekë specialistë.

Në 2017 janë pajisur me këtë certifikatë 175 mjekë të përgjithshëm dhe 32 mjekë specialistë.

Bankat e Universitetit të Mjekësisë nuk nxjerrin më shumë se 150 mjekë në vit, e ndërkohë në Shqipëri largohen çdo vit më shumë se 150 mjekë, qofshin këto të përgjithshëm apo specialist.

Shoqata "Together for Life", me mbështetjen e Friedrich Ebert Stiftung ka realizuar në 2018 një studim mbi largimin e mjekëve nga Shqipëria.¹ Ky studim merr në shqyrtim disa element në drejtim të largimit të trurit mjekësor, megjithatë ne do sjellim në vëmendje vetëm disa të dhëna nga anketa që është zhvilluar me mjekët.

Në bazë të vendit të punës, rezulton se nga mjekët e anketuar që punojnë në qendra shëndetësore, 16% do të largoheshin menjëherë, 63% do të largoheshin po t'u jepej mundësia dhe 21% shprehen se nuk do të largoheshin

Ndër mjekët që punojnë në qendrat shëndetësore të specialiteteve, 35% do të largoheshin menjëherë, 50% do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia dhe 15% nuk do të largoheshin.

Ndër mjekët që punojnë në spitalet bashkiake, vetëm 6% do të largoheshin menjëherë, 60% do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia dhe 34% nuk duan të largohen.

Ndër mjekët që punojnë në spitalet rajonale, 21% do të largoheshin menjëherë, 55% do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia dhe 25% nuk duan të largohen.

Ndryshon situata me mjekët që punojnë në spitalet universitare. 54% e tyre janë gati të largohen menjëherë nga Shqipëria. 35% e tyre do të largoheshin po t'u jepej mundësia dhe vetëm 12% thonë që nuk duan të largohen.

¹ <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14924.pdf>

Tjetër e dhënë shumë i rëndësishme është edhe qyteti ku mjekët ushtrojnë profesionin.

Në rang qarku, rezulton se mjekët që preferojnë më shumë të largohen janë mjekët e qarkut të Durrësit, Lezhës dhe Dibrës, të cilët e kanë përkatësisht 3%, 0% dhe 5% dëshirën për të qëndruar në Shqipëri. Nga ana tjetër, qarku i Shkodrës, dallohet nga qarqet e tjera duke qenë se ka një përgjigje prej 50% të mjekëve të cilët shprehen se nuk duan të largohen nga Shqipëria.

Një çështje tjetër e rëndësishme për t'u parë është largimi i mjekëve sipas edukimit.

Kështu, rezulton se nga mjekët me gradë shkencore (DrSC, PhD), 32% do të largoheshin menjëherë, 51% do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia dhe vetëm 17% nuk do të largoheshin.

Ndërkohë, nga mjekët specialistë, rezulton se 21% e tyre do të largoheshin nga Shqipëria menjëherë, 51% do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia, ndërsa 28% nuk duan të largohen.

Ndër mjekët e përgjithshëm, 32% shprehin dëshirën për t'u larguar menjëherë nga Shqipëria, 57% shprehen se do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia dhe vetëm 11% thonë se nuk duan të largohen.

Të dhënat që vijnë nga studim, apo edhe nga studime të tjera janë shumë shqetësuese, e megjithatë nuk shihet se ndalimi i këtij fenomeni është prioritet nga qeveria.

Shqipëria në këto momente ka numrin më të ulët të doktorëve në rajon. Në Shqipëri janë 1.2 mjekë për 1000 banorë. Sipas të dhënave nga Observatori Global i Shëndetit, Shqipëria ka numrin më të ulët të mjekëve për banorë në rajon. Greqia ka 6.2 mjekë për 1000 banorë, Maqedonia 2.8, Mali i Zi 2.3, Serbia 2.4 dhe Bosnja 1.8 mjekë për 1000 banorë.

Tjetër problem është shpërndarja e pabarabartë e burimeve njerëzore në vend. Migrimi i madh i brendshëm nga zonat rurale në zonat urbane ka krijuar një qasje gjithnjë të pabarabartë ndaj kujdesit shëndetësor për popullatën. Trupa mjekësore prej zonave rurale, sidomos të thella, ka lëvizur drejt zonave urbane. Kjo lëvizje ka ndikuar edhe në ndryshimin e raporteve të mjekëve dhe infermierëve me popullsinë. Në janar qeveria vendosi vijimin e financimit për Programin e mbështetjes me bonusin 2.5 milionë lekë mbi pagën, për mjekët specialistë, që ofrojnë shërbim në spitalet rajonale apo bashkiake ku ka nevojë për shërbime

të specializuara. Megjithatë, nevojat për specialist në spitalet e qyteteve më të vogla janë shumë të mëdha akoma sot.

Po pse duan mjekët të largohen?

Kushtet më të mira të punës përbëjnë shkak për t'u larguar për 50% të mjekëve.

Sipas anketës së zhvilluar nga shoqata, rezulton se 26% e mjekëve deklarojnë se institucioni i tyre ka mangësi në të gjitha shërbimet, ndërkohë që 60% deklarojnë se institucioni ku punojnë ka mangësi në disa shërbime. Vetëm 9% e mjekëve deklarojnë se nuk ka mangësi në asnjë nga shërbimet, ndërkohë që 5% e mjekëve nuk kanë pranuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje

Ajo çka rezultoi ishte se vetëm 19% e mjekëve ishin të kënaqur në vendin e punës. Pjesa tjetër shprehen se ndihen nën presion (23%), të stresuar (24%), të pakënaqur (27%), të mbingarkuar me punë (27%), të zhgënjyer (22%), të nënvlerësuar (24%), të parespektuar (18%). Një përqindje e vogël (7%) janë shprehur dhe se titullari ka kërkesa të paarsyeshme.

Ajo çfarë është më shqetësuese është mungesa e besimit për ndryshimin e sistemit shëndetësor. Mjekët u pyetën edhe nëse besimi i mjekëve ndaj sistemit shëndetësor do të ndryshonte para se ata të largohen nga vendi. Nga përgjigjet e dala, rezulton se 51% e të intervistuarve mendojnë se besimi i tyre nuk do të ndryshojë, 28% e mjekëve nuk e dinë nëse do të ndryshojë besimi i tyre ndaj sistemit edhe para se ata të largohen, dhe vetëm 5% pohuan se besimi i tyre mund të ndryshojë para largimit.

Në përgjigje të pyetjes nëse mjekët mendojnë se e ardhmja në Shqipëri është e sigurt, nga intervistat e përpunuara rezulton se: 50% e mjekëve janë pesimistë në lidhje me të ardhmen, ata mendojnë se e ardhmja nuk do të jetë e sigurt në Shqipëri; 27% e tyre mendojnë se ndoshta kjo e ardhme do të jetë më e sigurt; vetëm 10% e tyre janë të mendimit se e ardhmja do të jetë më e sigurt në vend.

Në kushtet e punës që shqetësojnë mjekët, është edhe mungesa e infrastrukturës. Rrjeti i kujdesit shëndetësor parësor konsiston në 413 qendra shëndetësore. Në Shqipëri funksionojnë 42 spitale publike. Megjithatë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, spitale bashkiake ofrojnë me vështirësi shërbimet, kryesisht për arsye të mungesës së numrit të mjaftueshëm të mjekëve specialistë.

Spitale universitare, të përqendruara në Tiranë, tërheqin një fluks pacientësh në rritje, për shkak të mungesës së shërbimeve në spitale bashkiake e rajonale dhe anashkalimit ose mospërdorimit të sistemit të referimit.

Mungesa e vëmendjes ndaj sistemi shëndetësor, qoftë ndaj personelit apo ndaj infrastrukturës, është evidentuar edhe në raporte të shumta të partnerëve ndërkombëtar. Në një raport të Organizatës së Kombeve të Bashkuara thuhet:

“Duhet theksuar se shpenzimet publike për shëndetësinë si pjesë e PBB-së janë më të ulëta në Shqipëri (2.97%) sesa në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore, dhe parashikimet për vitet 2020-2022 tregojnë një ulje të lehtë në 2.94% deri në vitin 2022.

Kjo tendencë është veçanërisht shqetësuese nëse duhet të ndërtojmë dhe të fuqizojmë një sistem shëndetësor më të mirë. Projektioni i OBSH për vitin 2020-2022 tregon se Shqipëria do të shpenzojë për tre vitet e ardhshme më pak se 10% për shëndetin nga paratë e përgjithshme publike. Rënia e burimeve për kujdesin parësor është shqetësuese.

Strategjia për zhvillimin e kujdesit parësor në Shqipëri kërkon një buxhet të rritur në 25%. Roli i rëndësishëm i kujdesit parësor në përgjigjen dhe shërimin e COVID 19 është i rëndësishëm”.

PPP-të në shëndetësi

Kur flasim për keq-menaxhimin apo për mungesën e vëmendjes, nuk mund të rrijmë pa përmendur konçensionet. Shëndetësia shqiptare gjendet sot e shkatërruar nga konçensionet ose të ashtuquajturat PPP. Fondet e shëndetësisë sot thithen nga konçensionet të cilat nuk arrijnë të ofrojnë shërbimin për të cilin paguhen. Në vitin 2020 shëndetësia ishte sektori i tretë publik me peshën më të lartë të kontratave të tipit Partneritet Publik Privat (PPP), pas energjisë dhe transportit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka 4 kontrata koncesionare:

1. Shërbimi i sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale
2. Kontrolli Bazë Mjekësor, i njohur si Check-Up
3. Shërbimi i hemodializës
4. Ofrimi i shërbimeve laboratorike private në spitalet publike rajonale dhe në 2 spitale bashkiake

Këto 4 kontrata kanë një periudhë zbatimi 10-13 vjeçare dhe sipas përlogaritjeve do t'i kushtojnë buxhetit 45.4 miliardë lekë. Në vitin 2020, në buxhet parashikoheshin 4 miliardë lekë për këto koncesione. Në vitin 2019, pagesat për shërbimet PPP ishin 3.8 miliardë lekë. Zbatimi i kontratave të Partneritetit Publik-Privat (PPP) në shëndetësi filloi për herë të parë në vitin 2015 dhe, deri në maj të 2020-s, buxheti i shtetit ka paguar gjithsej rreth 12.2 miliardë lekë për koncesionet e shëndetësisë.

Partneriteti Publik-Privat është kritikuar haptazi nga institucione të shumta kombëtare e ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, për mos llogaritjen si duhet të raportit kosto-përfitime prej tyre dhe lënien e rrezikut më shumë palës shtetërore se privatit të kontraktuar. Pavarsisht se zbatimi i PPP në Shqipëri nisi në 2015, vetëm në 2018, nga presioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar, filluan të bëhen publike pagesat që shkonin për këto shërbime.

Deri sot, shihet qartazi se kompanitë private kanë qenë të orientuara nga maksimizimi i fitimit e nuk kanë qenë të gatshme të ndërmarrin asnjë risk. Kontratat koncesionare janë lidhur pa studime të qarta fizibiliteti dhe në këtë mënyrë, lënë shtigje të hapura për rritjen e financimeve në periudhat e mëvonshme. Në rastin e koncesionit të check-up, kompania e pezulloi përkohësisht aktivitetin në momentin kur shpërtheu pandemia e COVID-19 si dhe kompania është paguar për shërbimet e pakryera. Në rastin e kontratës së sterilizimit, koncesionari është paguar përtej parashikimeve fillestare.

Një raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit për koncesionin e ofrimit të shërbimeve laboratorike spitalore ka gjetur problematika të përbashkëta me koncesionin e sterilizimit duke vërejtur se janë planifikuar si duhen nevojat për shërbime laboratorike. Sipas këtij institucioni, "Projekti koncesionar/PPP" vetëm në vitin e parë të implementimit të tij, sipas studimit të fizibilitetit, ka përcaktuar rritjen

në financim të kërkuar me rreth 3.3 milionë euro nga situata ekzistuese. Sipas argumentimit të bërë në studimin e fizibilitetit, financimi aktual vlerësohet në rreth 5.4 milionë euro dhe shpenzimi i kërkuar për implementimin e PPP në vitin e parë vlerësohet në 8.7 milionë euro, nëse ky projekt do të realizohet duke argumentuar shtesën në financim prej 3.3 milionë eurosh.

Edhe kur konçensionet bëjnë sens dhe janë të nevojshme nga ana teknike, ato vijnë të shoqëruara me fatura shumë të larta. Pra automatikisht shikohet që nuk qeveria dështon të menaxhojë sistemin shëndetësor dhe është e prirur t'i ofrojë këto kontrata miqve të ngushtë të pushtetit. Në vend që fondet të shpenzohen me mençuri, aty ku duhen dhe si duhen, ato shkojnë direkt në xhepin e një grushti njerëzish duke privuar shqiptarët nga shërbimi i duhur. Dhe njëherë, shikohet qartë se sistemi ynë shëndetësor është në kolaps prej korrupsionit e keqmenaxhimit.

Sistemit shëndetësor në Shqipëri i erdh rasti të tregojë cilat ishin kapacitetet e tij gjatë pandemisë. Në dy raportet e para të publikuara nga Qëndresa Qytetare mbi shëndetësinë janë trajtuar tema të shumta në lidhje me menaxhimin e situatës në vend. Në këtë raport do mundohemi të bëjmë një përmbledhje të masave të marra, transparencës nga ana e institucioneve, numrave të deklarara nga qeveria.



Konkluzione

Për ta nisur, ajo për të cilën bien dakord të gjithë ekspertët është fakti se vendi ynë u gjet totalisht i papërgatitur për pandeminë. Kjo situatë kaq e vështirë vuri në vështirësi të gjithë globin. Ekspertët më të mëdhenj u afruan dhe qeveritë bënë një hap pas, duke ia lënë përgjegjësitë atyre që ishin më të aftë të përballeshin. E në Shqipëri, si gjithmonë, u bë e kundërta. Në vend që të ishin ekspertët ato që vendosnin, Shqipëria pati në front të parë, të gjithëditurit, politikanët.

COVID-19 u kthye në politikë, u përdor e nuk u konsiderua si një armik i përbashkët, por si një mjet për kredibilitet politik. Propaganda ishte kudo, në administratë, në qeveri, në komitetin e ekspertëve si dhe në stafet e spitaleve, të cilat asnjëherë nuk pranuan gabimet dhe mungesën e kushteve, por propaganduan për “sukseset” e tyre. Mbetet e pakuptimë se si mjekët, pikërisht ato që ishin harruar nga çdo qeveri, u bënë paterica të pushtetit duke i shërbyer propagandës.

‘Ekspertët’ arritën deri në pikën që kundërshtonin Organizatën Botërore të Shëndetësisë mbi nevojën për shtimin e testimeve, vetëm ngaqë u hap një debat publik mes pozitës e opozitës. ‘Ekspertët’ i mbyllën sytë përpara faktit që shqiptarët po trajtoheshin në shtëpi duke paguar nga xhepi i tyre trajtime shumë të shtrenjta. ‘Ekspertët’ mbyllën sytë para faktit që Shqipëria ka një vdekshmëri shumë të lartë në spitale. Këto e shumë të tjera janë prova të qarta se pandemia shërbeu më shumë për propagandë se për bashkim, e nuk u mor seriozisht as nga ekspertët as nga qeveria.

Mungesa e testimeve, mungesa e respiratorëve, mungesa e stafit të specializuar ishin vetëm disa nga problemet fillestare.

Në mars, Shqipëria do të jetë në muajin e dymbëdhjetë të pandemisë. Deri tani duhet të ishin nxjerrë disa mësimë e duhet të kishte ndryshim në menaxhimin e pandemisë. Por, fatkeqësisht nuk shihet se qeveria ka nxjerrë qoftë një mësim të vetëm. Mungesa e transparencës vazhdon, buxheti i 2021 parashikon pagesa të majme për konçesionet e shëndetësisë e proçesi I vaksinimit po ecën me ritme shumë të ngadalta.

Të katër konçesionet e shëndetësisë, check-up, sterilizimi, dializa dhe ai i fundmi i laboratorëve pritet të marrin gjithsej 4.6 miliardë lekë, ose 37

milionë euro, që përbën gati një të tretën e gjithë pagesave për koncesionet në 2021. Më i shtrenjti ndër të gjithë është sterilizimi i pajisjeve mjekësore gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, që pritet të marrë 1.7 miliardë lekë pagesa nga buxheti. Koncesioni i laboratorëve që nisi zbatimin në vitin që lamë pas, do marrë 1.28 miliardë lekë për 2021, ndërsa check-up dhe dializa do të marrin përkatësisht 876 mln lekë dhe 779 mln lekë.

Duhet theksuar se këto pagesa do të jepen në një kohë që vendi është në një emergjencë shëndetësore të shkaktuar nga pandemia e se të katër këto koncesione nuk kanë lidhje direkte, apo ofrojnë mbështetje për situatën e krijuar nga covid.

Shumë afër vendit tonë, qeveritë e marrin seriozisht ruajtjen e jetës së popullit që i shërbejnë. Në Serbi, janë plot 140 site vaksinimi në pothuajse çdo qytet. Vetëm në Beograd janë 18 site, ku vetëm në njërin nga këto mund të marrin vaksinën plot 8000 njerëz në ditë. Ndërkohë në Shqipëri, janë dhënë vetëm 975 dozat e para që erdhën nga një shtet anonim i BE dhe po vazhdohet me 1 mijë e 170 vakcina e para të kompanisë Pfizer, që arritën në Institutin e Shëndetit Publik, në Tiranë, me 1 shkurt. Sipas autoriteteve shëndetësore vaksinat do të përdoren për personelin mjeko-sanitar dhe për moshat më të rrezikuara nga infektimi me covid. Në opinionin publik ende ka mungesë informacioni për çmimin që ka paguar qeveria ndaj kompanisë Pfizer apo mënyrës sesi mbërritën në Tiranë dozat e para të ardhura nga një vend i BE.

E ndërkohë, numrat vetëm rriten. Në këto ditë kemi parë shifra rekord, me rreth 1 mijë të prekur në ditë e me një pozitivitet shumë të lartë. 1 në 3 njerëz që testohen, dalin pozitiv. Masa të shumta janë akoma në fuqi. Prej muajit nëntor Komiteti Teknik i Eksperteve ka ndaluar grumbullimin e me shumë se 10 personave, takimet elektorale, si dhe ka zgjatur pa afat mbylljen e auditorëve në universitete.

Studentët janë një nga grupet më të prekur nga pasojat e pandemisë, duke qënë se arsimimi, për të cilin ato dhe familjet e tyre kanë investuar shumë, po dështon. Mësimi online po i mban larg studentët nga auditorët e larg nga dija. Këto kufizime ama nuk i mbajnë larg nga takimet partiake. Paradoksisht, ato që nuk mund të 'grumbullohen', nuk përbëjnë rrezik aspak kur afrohen në takimet partiake. Partitë politike kanë harruar se grumbullimet janë të ndaluara e se në fund të fundit, jeta vlen më shumë së fushata.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI
SHËNDETËSIA & MBROJTJA SOCIALE
Nëntor 2020 -Janar 2021